

## **SYLLABUS I LËNDËS: Menaxhim i dijes**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Ekonomisë
<b>Titulli i lëndës:</b>	Menaxhim i dijes
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	Zgjedhore
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti III, Semestri VI
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+1
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	4
<b>Koha / lokacioni:</b>	Përcaktohet nga Dekanati
<b>Mësimdhënësi:</b>	Prof. Asoc.dr. Veton Zeqiraj
<b>Detajet kontaktuese:</b>	veton.zeqiraj@uni-pr.edu
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Shumë kompani dhe universitete e kanë të qartë se suksesi i tyre në treg dhe përballimi i konkurrencës varet nga kompetencat, kapitali intelektual, i cili përfshin diturinë e cila të mundëson të dish çka duhet të bësh, mundëson shkathtësitë dhe aftësitë praktike, të dish se si bëhen. Menaxhimi i dijes në organizatë prezantohet si koncept i të kuptuarit sistematik të ndryshimeve në rrethinë, aftësi për të gjetur zgjidhje, pra të jemi kreativë, të dimë pse i bëjmë punët ashtu si i bëjmë, motivin individual që e nxit këtë kreativitet dhe interesin e organizatës; çka duhet të dijë dhe në çfarë formash duhet të ekzistojë dituria në organizatë; si të promovohet një kulturë e favorshme në organizatë për të mësuar, kultura e ndarjes së diturisë me anëtarët e tjerë të kolektivit, si dhe procesi për krijimin dhe ruajtjen e kësaj diturie të nevojshme në organizatë.</p> <p>Në një konkurrencë ndërkombëtare, ku kjo konkurrencë është e përhapur në mënyrë globale, roli i diturisë si aset strategjik po bëhet gjithnjë e më i theksuar. Për dallim nga kapitali dhe mjetet, dituria e koncentruar në fuqinë punëtore shërben jo vetëm në organizatë, por edhe për të mirën e shoqërisë në nivel të gjerë nga të mirat që i prodhon dhe u ofron kësaj shoqërie. Shfrytëzimi dhe shpërndarja e saj pasi të jetë bërë publike është shumë e lehtë dhe nuk e ka koston që e ka pasur deri sa është arritur dituria, por pas zbulimi, dituria ka një kosto shumë më të ulët se investimi që është bërë deri sa është përvetësuar ajo dituri.</p>
<b>Qëllimet e lëndës</b>	<p>Qëllimi i kësaj lëndë është të aftësojë studentin me dituri të mjaftueshme që të menaxhojë proceset e zhvillimit të BNP në ndërmarrje, të rinovojë diturinë e tyre dhe të shpërndajë këtë dituri brenda subjektit të vetë ekonomik dhe me gjere, të beje transferin e diturisë brenda dhe jashtë organizatës, të studiojë dhe të përfitojë shkathtësi të mjaftueshme për të njohur dhe zhvilluar këto procese në ndërmarrje. Tu mundësojë studentëve që ta njohin ndikimin e rrethinës në zhvillimin e dijes dhe ndikimet e sajë në ndërmarrje. Të ofrojë mundësi që nëpërmjet këtij</p>

	programi të studiohet metodologjia e zhvillimit të dijes, menaxhimit të saj , ta mësojë që diturinë e fituar ta zbatojë në ndërmarrje, institucione. Trajtimi i aspekteve praktike të menaxhimit të dijes.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Do të ngritë aftësitë intelektuale, studentët do të kuptojnë rëndësinë e dijes në ngritjen e aftësive dhe shkathhtësive të punëtorëve</li> <li>✓ Tu mundësojë studentëve që ta njohin ndikimin e rrethinës në zhvillimin e dijes dhe ndikimet e sajë në ndërmarrje</li> <li>✓ Te parashohë ndërrimet ne rrethine dhe ne baze te kësaj të jene ne gjendje të analizoje nevojat për dituri, të menaxhoje këtë dituri për nevojat e ndërmarrjes</li> <li>✓ Do të ngritë aftësitë për të lidhur strategjinë e resurseve njerëzore, dijes se tyre me strategjisë e ndërmarrjes</li> <li>✓ Do të rrisë aftësitë për të kuptuar, zhvilluar dhe zbatuar sistematikisht zhvillimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore për interes të zhvillimit të organizatës dhe individit</li> <li>✓ Trajtimi i aspekteve praktike të menaxhimit të dijes</li> </ul>
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit</b>	
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b> <b>Ditë/javë</b> <b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2                      13                      26
Ushtrime	1                      15                      15
Punë praktike	0                      0                      0
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	20 min.              15                      5
Ushtrime në teren	/                      /                      /
Kollokviume	2                      2                      4
Koha e studimit vetanak të studentit	2                      15                      30
Përgaditja përfundimtare për provim	1                      10                      10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3                      2                      6
Projekte, prezantime	1                      4                      4
<b>Totali</b>	<b>100</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies</b>	<p>Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjërataës, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vetëvlerësimeve periodike.</p> <p>Metoda e punës gjatë orëve ligjërata do të përqendrohet në ligjërata dhe diskutime interaktive me pjesëmarrje të studentëve në procesin e mësimin, me prezantime individuale e grupore, të punimeve të ndryshme të përgatitura nga studentët.</p> <p>Studentët inkurajohen që paraprakisht të hulumtojnë dhe lexojnë materiale rreth temave vijuese, në mënyrë që të jenë më të përgatitur në orë të mësimin për të zhvilluar diskutime interaktive në mes të tyre me qëllim të përvetësimit më të shpejtë dhe më të thellë të çështjeve të rëndësishme të lëndës.</p>
<b>Metodat e vlerësimit</b>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive të fituara bëhet përmes:</p> <p>a) vijueshmërisë në ligjërata 20 pikë</p> <p>b) aktiviteti (diskutimet): 10 pikë</p>

	<p>c) punimi seminarik - punuar në mënyrë individual: 10 pikë</p> <p>e) testi i parë: 30 pikë</p> <p>f) testi i dytë: 30 pikë</p> <p>Gjithsej: 100 pikë</p> <p>Vlerësimi i provimit përfundimtar, që vlerësohet me 51% të suksesit, me një sistem të ndërtimit të mëtejshëm të notës përfundimtare me kriteret tjera të lartë përmendura.</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<p>- Ymer Havolli, “Menaxhimi i dijes”, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë, 2017</p> <p>- Veliu L., “Menaxhim i dijes”, Ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2022</p>
Literatura shtesë:	<p>- Joseph Hilger, Zachary Wahl, “Making Knowledge Management Clickable: Knowledge Management Systems Strategy, Design, and Implementation” 1st ed. 2022 Edition, ISBN-13: 978-3030923846, ISBN-10: 3030923843, Springer, 2022</p> <p>- Santhosh Shekar, “Design Knowledge Management System: a practical guide for implementing ISO 30401 KMS standard”, Penman Books, 2021</p> <p>- Peter Massingham, “Knowledge Management: Theory in Practice”, 1st Edition, SAGE Publications Ltd, ISBN-13: 978-1473948198, ISBN-10: 1473948193, 2019</p> <p>- Klaus North, Gita Kumta, “Knowledge Management: Value Creation Through Organizational Learning”, (Springer Texts in Business and Economics) 2nd Edition, Springer, 2018</p>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e I-rë:</i>	Prezantimi i syllabusit / Koncepti i diturisë / Zhvillimi historik i diturisë
<i>Java e II-të:</i>	Kuptimi i menaxhimit të dijes / Llojet e diturive
<i>Java e III-të:</i>	Rëndësia e diturisë për ndërmarrje
<i>Java e IV-të:</i>	Dimensionet e menaxhimit të dijes
<i>Java e V-të:</i>	Definimi i transferit të diturisë
<i>Java e VI-të:</i>	Modeli i rritjes së dijes, shkaqet e ekspansionit të dijeve
<i>Java e VII-të:</i>	Testi i parë
<i>Java e VIII-të:</i>	Ekonomia e dijes
<i>Java e IX-të:</i>	Kultura dhe dituria / Ndërmarrjet që mësojnë
<i>Java e X-të:</i>	Ndërtimi i kornizës së menaxhimit të dijes në organizatë
<i>Java e XI-të:</i>	Menaxhimi i rrjedhës së dijes / Mjetet për menaxhimin e diturisë
<i>Java e XII-të:</i>	Kompetencat, rëndësia dhe përdorimi i tyre
<i>Java e XIII-të:</i>	Kapitali intelektual
<i>Java e XIV-të:</i>	Performancat e nevojshme të burimeve njerëzore si element i diturisë
<i>Java e XV-të:</i>	Testi i dytë
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shitesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.